

L I G J
Nr. 8873, datë 29.3.2002

PËR SIGURIMIN E DEPOZITAVE

(Ndryshuar me ligjin nr. 10 106, datë 30.3.2009; nr. 78/2012, datë 26.7.2012)

(i përditësuar)

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim të rregullojë sigurimin dhe kompensimin e depozitave, si dhe krijimin, përgjegjësitë dhe veprimtarinë e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave.

Neni 2

Përcaktime

(Ndryshuar shkronja “c”, “d”, “e”, “f”, shtuar shkronja “n” me ligjin nr. 10 106, datë 30.3.2009; shtuar shkronja “ç/1”, “d/1”, nëndarja “iii” e shkronjës “f”, ndryshuar shkronja “ll” me ligjin nr. 78/2012, datë 26.7.2012)

Për qëllimin e këtij ligji, përveçse kur përcaktohet ndryshe në këtë ligj, termat e mëposhtëm kanë kuptimin:

a) “Agjencia” është Agjencia e Sigurimit të Depozitave, e krijuar sipas dispozitave të këtij ligji;

b) “Autoriteti Mbikëqyrës” është Banka e Shqipërisë;

c) Akt nënligjor” është akti i Autoritetit Mbikëqyrës dhe/ose këshillit drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, i dalë në bazë dhe për zbatim të këtij ligji;

ç) “Bankë” është personi juridik që pranon dhe grumbullon depozita ose fonde të tjera të ripagueshme për publikun dhe jep kredi, paradhënie, hua ose investon për llogari të tij, sipas licencës së dhënë nga Autoriteti Mbikëqyrës;

ç/1) “Shoqëria e kursim-kreditit (SHKK)” është personi juridik, i cili themelohet dhe vepron në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në ligjin nr. 8782, datë 3.5.2001 “Për shoqëritë e kursim- kreditit”, të ndryshuar;

d) “Bankë e siguruar” është banka apo dega e bankës së huaj në Shqipëri që pranon depozita të siguruara nga Agjencia;

d/1) “Subjekt i siguruar” është banka dhe dega e bankës së huaj në Shqipëri, shoqëria e kursim-kreditit që pranon depozita të siguruara nga Agjencia;

dh) “Degë e bankës” është njësi organizative e bankës nën varësinë e drejtorisë qendrore të saj, që kryen drejtpërsëdrejti të gjitha ose disa veprimtari të bankës;

e) “Degë e bankës së huaj në Shqipëri” ka kuptimin e përcaktuar në paragrafin e parë të pikës 15 të nenit 4 të ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”;

ë) “Dega e bankës jashtë Shqipërisë” është njësi organizative e bankës jashtë territorit

të Republikës së Shqipërisë, që kryen drejtpërsëdrejti të gjitha ose disa veprimtari të bankës, drejtoria qendrore e së cilës është në territorin e Republikës së Shqipërisë;

f) Depozitë” është:

i) teprica kreditore, e cila rezulton nga fondet e depozituara në një llogari ose në njërën nga gjendjet e përkohshme, që rrjedhin nga veprimet e zakonshme bankare dhe që banka duhet t’i ripaguajë, sipas dispozitave të një kontrate ose dispozitave ligjore;

ii) çdo detyrim i vërtetuar nëpërmjet një dokumenti apo vërtetimi të lëshuar nga banka ose dega e bankës së huaj;

iii) çdo shumë parash, që anëtar, individ i shoqërisë së kursim-kreditit depoziton pranë saj, në përputhje me ligjin nr. 8782, datë 3.5.2001 “Për shoqëritë e kursim-kreditit”, të ndryshuar;

g) “Depozitë e siguruar” është depozita që sigurohet dhe kompesohet në mbështetje dhe në zbatim të dispozitave të këtij ligji;

gj) “Depozitë e pasiguruar” është depozita e përjashtuar nga sigurimi dhe kompensimi i depozitave, në mbështetje dhe në zbatim të dispozitave të këtij ligji;

h) “Llogari depozitë” është llogaria në bankën e siguruar ose në degën e bankës së huaj, në të cilën vendosen fondet e depozituesit, në lekë ose në monedhë të huaj. Llogaria depozitë është e të gjitha llojeve, duke përfshirë llogarinë bankare, depozitë me afat, pa afat, likuiduese dhe atë të kursimit;

i) “Depozitues” është çdo person që, sipas përcaktimeve të këtij ligji, ka të drejtën e ripagimit për depozitën nga banka, përveç depozituesve të përjashtuar nga sigurimi dhe kompesimi i depozitave, sipas dispozitave të këtij ligji;

j) “Depozitë e përbashkët” është llogaria bankare depozitë e vendosur në emër të dy a më shumë personave ose mbi të cilën dy ose më shumë persona kanë të drejtën e kryerjes së veprimeve kundrejt nënshkrimit;

k) “Depozitë e të tretëve” është llogaria depozitë, mbi të cilën personi i tretë, i ndryshëm nga personi në emër dhe për llogari të të cilit është vendosur llogaria depozitë, kryen veprime kundrejt nënshkrimit dhe nëpërmjet një përfaqësuesi ligjor;

l) “Kompensim” është pagimi nga Agjencia, sipas procedurave të përcaktuara në këtë ligj, për llogari të depozitës së siguruar;

ll) “Ndërhyrje” është vënia në likuidim të detyruar e subjektit të siguruar me vendim të Autoritetit Mbikëqyrës;

m) “Person” është çdo individ, rezident ose jorezident, shqiptar ose i huaj;

n) “Dita e vlerësimit” është dita kur kryhet përlllogaritja e depozitave të siguruara, për efekt të përlllogaritjes së primit.

Neni 2/1

(Shtuar me ligjin nr. 78/2012, datë 26.7.2012)

Kudo në këtë ligj fjalët “bankë e siguruar” zëvendësohen me fjalët “subjekt i siguruar”, me përjashtim të neneve 23 dhe 26 të këtij ligji.

Neni 3

Juridiksioni

(Shtuar pika 3 me ligjin nr. 78/2012, datë 26.7.2012)

1. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, depozita në bankë sigurohet nga Agjencia, sipas dispozitave të këtij ligji dhe asnjë bankë nuk pranon dhe nuk grumbullon depozita kur nuk është e siguruar nga Agjencia, sipas dispozitave të këtij ligji, përveç depozitave në degën e bankës jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

2. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, depozitat në degën e bankës së huaj që vepron në territorin e Republikës së Shqipërisë sigurohen nga Agjencia, sipas dispozitave të këtij ligji dhe asnjë degë e bankës së huaj që vepron në territorin e Republikës së Shqipërisë nuk pranon dhe nuk grumbullon depozita kur nuk është e siguruar nga Agjencia konform këtij ligji.

3. Depozita në shoqëritë e kursim-kreditit sigurohet nga Agjencia, sipas dispozitave të këtij ligji dhe akteve rregullatore, dhe asnjë shoqëri e kursim-kreditit nuk pranon dhe nuk grumbullon depozita kur nuk është e siguruar nga Agjencia, sipas dispozitave të këtij ligji.

Neni 4

Depozitat e siguruara

(Ndryshuar fjalë në pikën 4, shtuar pika 4/1 me ligjin nr. 10 106, datë 30.3.2009)

1. Për çdo depozitë të siguruar llogaritet teprica kreditore e llogarisë depozitë dhe interesi i llogaritur deri në ditën e ndërhyrjes. Për llogaritjen e depozitës së siguruar, nga teprica kreditore e llogarisë depozitë zbritet depozita e pasiguaruar së bashku me interesin e llogaritur.

2. Depozitat e siguruara mund të jenë në lekë ose në monedhë të huaj.

3. Për qëllim të këtij ligji, depozitat e siguruara të çdo depozituesi për çdo bankë të siguruar, të vendosura në disa llogari depozitë, llogariten të gjitha së bashku dhe konsiderohen si një llogari depozitë e vetme. Depozitat në valutë konvertohen në lekë, sipas kursit zyrtar të këmbimit të përcaktuar nga Autoriteti Mbikëqyrës në ditën e ndërhyrjes.

4. Në rastet e transformimit të bankës së siguruar, nëpërmjet bashkimit, shkrirjes, ndarjes ose nëpërmjet ndonjë mënyre tjetër, depozitat e siguruara në bankat pjesëmarrëse, mbeten të siguruara, për secilën bankë pjesëmarrëse në këtë proces, tre muaj prej datës që Agjencia njoftohet me shkrim nga Autoriteti Mbikëqyrës për përfundimin e procesit të transformimit.

4.1. Në rastin e likuidimit vullnetar të bankës së siguruar, depozitat mbeten të siguruara, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, deri në përfundim të këtij procesi. Në çdo rast, Agjencia kompenson depozitat vetëm pas njoftimit, me shkrim, nga Autoriteti Mbikëqyrës për ndërhyrjen në bankën e siguruar.

5. Në zbatim të këtij ligji, depozita mbetet e siguruar deri në kryerjen e kompensimit nga Agjencia, pavarësisht nga ndërhyrja ose revokimi i licencës së bankës së siguruar.

6. Sigurimi i depozitës, sipas këtij ligji, përfundon kur:

- a) depozita klasifikohet si depozitë e pasiguaruar;
- b) depozita kompensohet nga Agjencia.

Neni 5

Depozitat e pasiguaruara

(Ndryshuar shkronja "a" dhe "d" me ligjin nr. 10 106, datë 30.3.2009; ndryshuar shkronja "c" dhe "gj" me ligjin nr. 78/2012, datë 26.7.2012)

Depozitat e mëposhtme përjashtohen nga sigurimi dhe kompensimi nga Agjencia, sipas dispozitave të këtij ligji (depozitat e pasiguaruara):

- a) pjesa e depozitës mbi 2 500 000 (dy milionë e pesëqind mijë) lekë ose shuma e barasvlershme me të (kundërvleftën), në monedhë të huaj;
- b) depozitat e çdo shoqërie tregtare, personi fizik ose personi tjetër juridik;
- c) depozitat e drejtorit, të administratorëve të subjektit të siguruar ose të çdo depozituesi tjetër me të njëjtin status në personat juridikë të lidhur me subjektin e siguruar në fjalë;
- ç) depozitat e çdo personi që zotëron, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të drejtën e pronësisë të një aksioneri në masën 5 për qind (pesë për qind) ose më shumë në kapitalin e bankës së siguruar ose të aksioneve me të drejtë vote të lidhur me bankën në fjalë;

d) depozitat e personave, të cilët kryejnë detyrën e auditimit dhe certifikimin e llogarive kontabël në bankat e siguruara, si dhe depozituesit me të njëjtin status në shoqëritë e tjera të të njëjtit grup;

dh) depozitat e çdo depozituesi të bankës së siguruar, që gëzon më shumë se 20 për qind (njëzet për qind) interes preferencial, të ndryshëm nga interesi i zbatuar sipas kushteve të punës për të gjithë depozituesit e tjerë të kësaj banke;

e) depozitat e çdo personi në bankën e siguruar, që përdor llogarinë depozitë për veprimtari kriminale;

ë) depozitat jonominate, përfshirë depozitat në letrat me vlerë të prurësit;

f) depozitat në degën e bankës jashtë Shqipërisë;

g) depozitat e vendosura në bankën e siguruar gjatë dhe pas ditës së ndërhyrjes në këtë bankë;

gj) depozitat e personave juridikë në shoqërinë e kursim-kreditit.

Neni 6

Kompensimi i depozitës së siguruar

(Ndryshuar pikat 1 dhe 2, shtuar shkronjat “ç”, “d”, “dh” dhe “e” në pikën 4, shtuar pika 5/1 me ligjin nr. 10 106, datë 30.3.2009; ndryshuar pika 1, ndryshuar shkronja “c” e pikës 4, me ligjin nr. 78/2012, datë 26.7.2012)

1. Agjencia kompenson depozitat e siguruara kur Autoriteti Mbikëqyrës ndërhyr në subjektin e siguruar.

2. Agjencia kompenson depozitën e siguruar, sipas dispozitave të këtij ligji, në masën 100 për qind dhe, në çdo rast, jo më shumë se 2 500 000 (dy milionë e pesëqind mijë) lekë, për çdo depozitues në çdo bankë të siguruar, që operon në Republikën e Shqipërisë, pavarësisht numrit të depozitave apo shumës së depozituar.

3. Në zbatim të pikave 2 dhe 4 të këtij neni, niveli i kompensimit për çdo depozitues llogaritet mbi shumën agregate të depozitave të siguruara të këtij depozituesi në një bankë, në ditën e ndërhyrjes, pa marrë parasysh numrin e depozitave, llojin e monedhës së depozituar ose të pagueshme, si dhe vendin në të cilin vendosen këto depozita në Republikën e Shqipërisë.

4. Për përcaktimin e shumës së depozitës së siguruar për kompensim nga Agjencia, sipas pikës 2:

a) depozitat në afat vlerësohen të përfunduara në afat në ditën e ndërhyrjes;

b) depozitat e siguruara llogariten sipas nenit 4 pika 1 të këtij ligji, duke përfshirë tepricën kreditore dhe interesin e llogaritur deri në ditën e ndërhyrjes dhe depozitat e siguruara në monedhë të huaj këmbehen në lekë, sipas kursit zyrtar të këmbimit të përcaktuar nga Autoriteti Mbikëqyrës në ditën e ndërhyrjes;

c) depozitat e siguruara, të mbajtura nga çdo depozitues në subjektin e siguruar në ditën e ndërhyrjes, agregohen. Në mbështetje dhe për zbatimin e këtij ligji, agregim është llogaritja e shumës së përgjithshme të depozitave të siguruara të një depozituesi në subjektin e siguruar, duke zbritur vetëm shumën e detyrimeve të papaguara në kohë të depozituesit ndaj subjektit të siguruar, që rezulton në vonesë shlyerjeje në ditën e ndërhyrjes nga Autoriteti Mbikëqyrës;

ç) në rastin e depozitave të përbashkëta, pjesa përkatëse e secilit prej depozituesve merret parasysh në llogaritjen e shumës së përgjithshme të depozitave që ka depozituesi në bankën e siguruar. Përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe në kushtet e vendosjes së depozitës, çdo depozitues prezumohet se zotëron pjesë të barabarta në depozitën e përbashkët;

d) në rastin e depozitave të vendosura si garanci për një person të tretë, të drejtat për kompensim të depozitës i njihen titullarit të depozitës, në përputhje me specifikimet e nënpikës “i” të shkronjës “dh” të kësaj pike. Në rastin e depozitave të vendosura në përfitim të një personi të tretë, të drejtat për kompensim të depozitës i njihen këtij të fundit, në përputhje me

specifikimet e nënpikës “ii” të shkronjës “dh” të kësaj pike. Në rastin e depozitës së vendosur në përfitim ose si garanci të më shumë se një personi të tretë, zbatohen rregullat e parashikuara për depozitat e përbashkëta;

dh) në rastin e depozitave të vendosura në përfitim ose si garanci të personit ose të personave të tretë, shuma e depozitës/depozitave në fjalë merret parasysh në llogaritjen e shumës së përgjithshme të depozitave, që ka depozituesi në bankën e siguruar;

i) në rastin e depozitave që shërbejnë si garanci, shuma e kompensimit për këtë depozitë nuk do t’i paguhet titullarit të depozitës deri në çastin kur ai është liruar nga detyrimi i garancisë. Në rast se titullari nuk arrin të lirohet nga detyrimi i garancisë, shuma e kompensimit përfitohet nga personi i tretë, në favor të të cilit është vendosur garancia;

ii) në rastin e depozitave të vendosura me kusht ose me afat në përfitim të personit të tretë, ky i fundit përfiton shumën e kompensimit me përfundimin e afatit ose me plotësimin e kushtit përkatës. Në të kundërt, shuma e kompensimit përfitohet nga titullari i depozitës ose trashëgimtarët e tij;

e) në rast se ka një vendim gjyqësor për subjektin, që përfiton kompensimin e depozitave të përmendura në shkronjat “ç”, “d” e “dh” të këtij neni, Agjencia kryen kompensimin, në përputhje me këtë vendim gjyqësor.

5. Agjencia ka të drejtë të refuzojë kompensimin ose të kërkojë kthimin e kompensimit për depozitat e siguruara, kur e drejta për kompensim bazohet në të dhëna të pavërteta dhe mashtruese.

5/1. Me përfundimin e afatit ligjor të procesit të kompensimit, fondi i mbetur i kompensimit për depozitat e siguruara, i përbërë nga shumat e kompensimit që mbeten të pashlyera deri në përfundim të këtij afati, transferohen prej Agjencisë në një llogari të veçantë pranë Autoritetit Mbikëqyrës. Në përputhje me dispozitat e këtij ligji, depozituesit mund të paraqiten në çdo kohë pranë Agjencisë për tërheqjen e shumës së kompensimit.

6. Çdo depozitues ka të drejtë të depozitojë një ankesë në Autoritetin Mbikëqyrës. Vendimi i Agjencisë zbatohet pa kufizim gjatë periudhës së ankimit dhe çdo apelimi tjetër ose procesi tjetër juridik të lidhur me apelimin. Akti i Autoritetit Mbikëqyrës ankimohet, sipas ligjit “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 7

Kompensimi i depozitës së siguruar dhe cedimi

(Ndryshuar pikat 1, 2 dhe 3 me ligjin nr. 10 106, datë 30.3.2009; hequr fjalë në pikën 1, ndryshuar pika 3, shtuar pika 6, me ligjin nr. 78/2012, datë 26.7.2012)

1. Kompensimi për llogari të depozitave të siguruara fillon menjëherë pasi Agjencia njoftohet, me shkrim, nga Autoriteti Mbikëqyrës për ndërhyrjen të bankës së siguruar. Kompensimi përfundon jo më vonë se tre muaj nga data e fillimit të procesit të kompensimit.

Në raste të veçanta, këshilli drejtues i Agjencisë i kërkon Autoritetit Mbikëqyrës të vendosë përjashtimisht zgjatjen e afatit të kryerjes së kompensimit, por jo më shumë se dy herë për periudha tremujore.

2. Agjencia kompenson depozitën e siguruar si më poshtë:

a) nëpërmjet njohjes së të drejtës së kthimit të fondeve për shumën e depozituar dhe të transferuar në një bankë tjetër të siguruar, deri në nivelin e kompensimit, sipas dispozitave të këtij ligji;

b) nëpërmjet pagimit të shumës në lekë personit, sipas nivelit të kompensimit;

c) nëpërmjet një banke të siguruar. Kriteret e përzgjedhjes së bankës së siguruar propozohen nga këshilli drejtues i Agjencisë dhe miratohen me akt nënligjor nga Autoriteti Mbikëqyrës. Banka e siguruar, që do të kryejë procesin e kompensimit, caktohet me vendim të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë, në përputhje me kriteret e përzgjedhjes, të përcaktuara

në aktin nënligjor përkatës të Autoritetit Mbikëqyrës.

3. 3. Kur shuma e kërkuar për kompensimin e depozitave të siguruar është më e madhe se mjetet financiare të zotëruara nga Agjencia, atëherë kjo e fundit:

a) mund të marrë hua nga Buxheti i Shtetit, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Masa e huas që do të jepet përcaktohet në mënyrë që kapaciteti financiar i Agjencisë të jetë në proporcion me detyrimet e saj dhe në çdo rast duhet të sigurojë qëndrueshmërinë e sistemit bankar e financiar në vend, si dhe të jetë në përputhje me qëndrueshmërinë e financave publike, në këndvështrimin afatmesëm dhe afatgjatë.

b) Interesi i huas që do të jepet, sipas shkronjës “a” të kësaj pike, duhet të jetë i njëjtë me normat e interesit të titujve, me maturitet të krahasueshëm, të emetuar nga Qeveria Shqiptare e të tregtueshëm në Republikën e Shqipërisë.

c) Për dhënien e huas, sipas shkronjave “a” dhe “b” të kësaj pike, Ministria e Financave lidh marrëveshje me Agjencinë dhe Autoritetin Mbikëqyrës, ku përcaktohen, ndër të tjera, kushtet e kësaj huaje.

4. Me pagimin e kompensimit të depozitës së siguruar, sipas dispozitave të këtij ligji, Agjencisë i cedohen të gjitha tagrat dhe të drejtat e depozituesit deri në shumën e kompensuar. Me likuidimin e bankës, pretendimet e Agjencisë renditen në radhë, së bashku me depozituesit e vegjël, sipas ligjit “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”. Veprimet ose mosveprimet në përdorimin e së drejtës dhe të tagrave mbahen nga Agjencia në emër dhe për llogari të depozituesit ose të vetë Agjencisë deri në nivelin e kompensimit të depozitave.

5. Cedimi i të drejtave dhe tagrave të depozituesve të kompensuar në Agjenci, sipas pikës 4 të këtij neni, nuk cenon të drejtat e këtyre depozituesve ndaj bankës për llogari të këtyre depozitave deri në atë masë sa teprica kreditore kalon nivelin e kompensimit të paguar nga Agjencia.

6. Në rastin e transferimit të disa ose të të gjitha aseteve dhe detyrimeve të subjektit të siguruar te një subjekt tjetër i siguruar ose një bankë-urë, përfshirë në çdo rast totalin e depozitave të siguruar, në bazë të urdhrit të Autoritetit Mbikëqyrës ose gjatë procesit të kujdestarisë apo likuidimit, Agjencia, me miratimin e Autoritetit Mbikëqyrës, transferon mjetet e saj financiare të nevojshme për plotësimin e diferencës ndërmjet detyrimeve dhe aseteve që transferohen, nëse vlera e detyrimeve është më e madhe se vlera e aseteve.

a) Plotësimi i diferencës, nga ana e Agjencisë, ndërmjet detyrimeve dhe aseteve që transferohen, kryhet deri në shumën e depozitave të siguruar dhe vetëm nëse kjo mënyrë është më pak e kushtueshme se kryerja e procesit të kompensimit të depozitave, duke përfshirë të gjitha shpenzimet që lidhen me këtë proces.

b) Pretendimet e Agjencisë, të cilat rrjedhin nga plotësimi i diferencës midis detyrimeve dhe aseteve të transferuara, renditen në radhë së bashku me depozituesit e vegjël, sipas ligjit “Për bankat në Republikën e Shqipërisë.

Neni 8

(Shtuar pika 6 dhe 7 me ligjin nr. 78/2012, datë 26.7.2012)

1. Në mbështetje dhe për zbatimin e këtij ligji themelohet Agjencia e Sigurimit të Depozitave. Agjencia është person juridik publik, me qendër në Tiranë.

2. Agjencia, brenda përgjegjësisë së përcaktuar në këtë ligj, gëzon pavarësi operacionale dhe financiare nga çdo subjekt tjetër.

3. Agjencia, për veprimtarinë vjetore të saj, raporton në Kuvend, në Këshillin e Ministrave dhe në Autoritetin Mbikëqyrës.

4. Agjencia shpërndahet dhe likuidohet me ligj.

5. Agjencia përjashtohet nga të gjitha tatimet dhe taksat e drejtpërdrejta.

6. Ekzekutimi i detyrimeve të lindura për Agjencinë gjatë procesit të kompensimit

pezullohet, sipas dispozitave të parashikuara në Kodin e Procedurës Civile, deri në përfundimin e plotë të këtij procesi.

7. Vetëm për qëllim të kryerjes së procesit të kompensimit, sipas dispozitave të këtij ligji, Agjencia përjashtohet si subjekt i dispozitave të ligjit “Për prokurimin publik” dhe të akteve nënligjore në fuqi për zbatimin e tij.

Neni 9

Të drejtat dhe detyrimet e Agjencisë dhe bankave të siguruara

(Ndryshuar me ligjin nr. 10 106, datë 30.3.2009)

1. Agjencia kompenson depozitat e siguruara deri në nivelin dhe sipas procedurave të përcaktuara në këtë ligj dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

2. Agjencia përgjigjet për administrimin e fondeve me efektivitet dhe në përputhje me standardet e pranura të menaxhimit të riskut.

3. Bankat e siguruara, me kërkesë të Agjencisë, dërgojnë pranë saj, sa herë që u kërkohen, informacione dhe dokumentacione për veprimtarinë, sipas dispozitave të këtij ligji, në veçanti për depozitat dhe depozituesit, metodologjinë e përlllogaritjes së primit dhe kontributit fillestar.

4. Në procedurat e kujdestarisë dhe të likuidimit, Agjencia, në veçanti, merr informacione të hollësishme për depozitat dhe depozituesit, të cilët përfitojnë nga skema e sigurimit të depozitave, sipas dispozitave të këtij ligji.

5. Agjencia ka të drejtë të ankimojë raportin e likuidatorit tek Autoriteti Mbikëqyrës, kur vëren se veprimet e propozuara nga ai, sipas ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, janë në kundërshtim me interesat e ligjshëm të saj.

6. Agjencia, nëse e çmon të nevojshme, sigurohet për saktësinë dhe integritetin e informacioneve dhe dokumentacioneve të lartpërmendura edhe nëpërmjet verifikimeve të kryera drejtpërsëdrejti në bankat e siguruara. Agjencia, në mënyrë të veçantë, verifikon te bankat e siguruara saktësinë e përlllogaritjes së primit, të të dhënave identifikuese të depozitueseve dhe depozitave për efekt kompensimi, si dhe për saktësinë e informimit të publikut për skemën e sigurimit.

7. Në mbikëqyrjen e bankave, në procesin e kujdestarisë dhe të likuidimit, Autoriteti Mbikëqyrës mbron interesat e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave dhe i jep asaj të dhëna, të cilat i shërbejnë për të kryer veprimtarinë e saj.

8. Agjencia, sipas rastit, kërkon nga Autoriteti Mbikëqyrës përfshirjen e përfaqësuesve të vet në ekzaminimet, që Autoriteti Mbikëqyrës kryen në bankat e siguruara.

9. Bankat e siguruara detyrohen të krijojnë sisteme për ruajtjen e të dhënave për llogaritjen e primit të sigurimit të depozitave, në përputhje me kërkesat e Agjencisë, të cilat përcaktohen me akt nënligjor.

10. Bankat e siguruara detyrohen të mbajnë informacion për depozitat dhe depozituesit, në përputhje me kërkesat e Agjencisë, që përcaktohen me akt nënligjor.

11. Agjencia shkëmben informacione dhe hyn në marrëveshje bashkëpunimi, në bazë reciprociteti, për përmbushjen e funksioneve të saj, me organizatat përgjegjëse homologe të vendeve të tjera.

Neni 10

Organizimi dhe drejtimi

Agjencia organizohet dhe administrohet nga Këshilli Drejtues dhe drejtohet nga Drejtori i Përgjithshëm.

Detyrat e Këshillit Drejtues

(Ndryshuar pika 2 me ligjin nr. 10 106, datë 30.3.2009; shtuar shkronjat “e/1” dhe “e/2” në pikën 2, shtuar nënndarja “vii” me ligjin nr. 78/2012, datë 26.7.2012)

1. Këshilli Drejtues është organi më i lartë vendimmarrës për veprimtarinë e Agjencisë.
2. Këshilli ka këto kompetenca:
 - a) vendos për kompensimin e depozitave të siguruara, sipas dispozitave të këtij ligji;
 - b) vendos për politikat e sigurimit të depozitave, në përputhje me këtë ligj;
 - c) vendos për politikat e administrimit të mjeteve financiare të agjencisë;
 - ç) vendos për pranimin dhe përjashtimin e bankave në sigurimin e depozitave, sipas dispozitave të këtij ligji;
 - d) mund të propozojë shtyrjen e afatit për kryerjen e procesit të kompensimit, sipas dispozitave të këtij ligji;
 - dh) përcakton primet vjetore të bankave të siguruara, në përputhje me këtë ligj;
 - e) përcakton kontributet fillestare të bankave të siguruara, në përputhje me këtë ligj;
 - e/1) propozon për Autoritetin Mbikëqyrës aktet nënligjore për miratimin e kontributit të veçantë që paguhet nga subjektet e siguruara, sipas dispozitave të parashikuara në nenin 20/1 pika 4 të këtij ligji;
 - e/2) propozon për miratim të Autoritetit Mbikëqyrës vendimin për transferimin e mjeteve financiare të Agjencisë për plotësimin e diferencës midis aseteve dhe detyrimeve që transferohen nga një subjekt i siguar te një subjekt tjetër i siguar ose bankë-urë, sipas vendimit të Autoritetit Mbikëqyrës për këtë transferim, në përputhje me pikën 6 të nenit 7 të këtij ligji;
 - ë) propozon për Autoritetin Mbikëqyrës akte nënligjore, me efekt për subjektet pjesëmarrëse në skemën e sigurimit të depozitave;
 - f) i propozon Këshillit të Ministrave një rritje të fondit themeltar dhe miraton kreditë, huatë, subvencionet ose donacionet për Agjencinë;
 - g) propozon shkarkimin e anëtarëve të këshillit drejtues, në përputhje me nenin 13 të këtij ligji;
 - gj) shqyrton projektbuxhetin e Agjencisë, cakton nivelin e pagave për Drejtorin e Përgjithshëm dhe personelin e Agjencisë, si dhe për shpërblimin e anëtarëve të këshillit drejtues, që ia paraqet për miratim Autoritetit Mbikëqyrës;
 - h) miraton kontrollorët e brendshëm dhe të jashtëm të Agjencisë dhe shqyrton raportet e tyre;
 - i) mbikëqyr veprimtarinë e Drejtorit të Përgjithshëm;
 - j) miraton raportet dhe rekomandimet për publikim;
 - k) miraton bilancin vjetor, raportet vjetore dhe raportet e tjera financiare të Agjencisë;
 - l) miraton programet vjetore të punës së Agjencisë;
 - ll) miraton të gjitha aktet nënligjore, që rregullojnë funksionimin e brendshëm të Agjencisë, në veçanti:
 - i) statutin;
 - ii) rregulloren e marrëdhënieve të punës së personelit;
 - iii) rregulloren për procedurat e mbledhjeve të këshillit drejtues;
 - iv) strukturën organizative;
 - v) rregulloret e brendshme të funksionimit të njësive organizative të Agjencisë;
 - iv) rregullat dhe procedurat e delegimit të kompetencave apo përgjegjësi;
 - vii) rregullat dhe procedurat për prokurimin e shërbimeve dhe mallrave gjatë procesit të kompensimit.

Neni 12

Përbërja e Këshillit Drejtues

1. Këshilli Drejtues përbëhet nga pesë anëtarë. Anëtarët e Këshillit Drejtues emërohen nga Autoriteti Mbikëqyrës, të propozuar si më poshtë:

- a) dy anëtarë nga Autoriteti Mbikëqyrës;
- b) dy anëtarë nga Ministri i Financave;
- c) një anëtar nga bashkimi profesional i ekspertëve kontabël.

2. Anëtarët e Këshillit Drejtues duhet të jenë personat që:

- a) janë shtetas të Republikës së Shqipërisë;
- b) kanë arsimin e lartë ekonomik ose juridik;
- c) kanë përvojë pune mbi shtatë vjet dhe kualifikime profesionale në çështje financiare dhe bankare;

ç) nuk kanë pengesa të parashikuara në nenin 13;

d) nuk janë punësuar nga Agjencia përveç Drejtorit të Përgjithshëm;

dh) nuk janë administratorë ose të punësuar në bankën e siguruar me ose pa shpërblim.

3. Afati i qëndrimit në detyrë për çdo anëtar të Këshillit Drejtues është pesë vjet, duke synuar që datat e mbarimit të këtij afati të çdo anëtari të Këshillit Drejtues, të jenë të shpërndara gjatë periudhës pesëvjeçare.

4. Përfaqësuesi i bankave të siguruara mund të marrë pjesë në mbledhjet e Këshillit Drejtues të Agjencisë pa të drejtë vote.

Neni 13

Shkarkimi i anëtarëve të Këshillit Drejtues

Çdo anëtar i Këshillit Drejtues, përfshirë Drejtorin e Përgjithshëm, shkarkohet nga Autoriteti Mbikëqyrës në rast se:

a) është në pamundësi për të shërbyer në Këshillin Drejtues, sipas nenit 12 të këtij ligji;

b) dënohet nga gjykata për një vepër penale;

c) është shpallur në paaftësi paguese ose ka qenë administrator në 5 vitet e fundit në një shoqëri tregtare, e cila është shpallur në paaftësi paguese;

ç) ndalohet ose pezullohet nga gjykata të ushtrojë detyrën si nëpunës shtetëror ose në shërbimin publik, ose të ushtrojë veprimtarinë apo mjeshtërinë;

d) është në marrëdhënie bashkëshortore ose gjaku, deri në shkallë të dytë, me anëtarët e tjerë të Këshillit Drejtues të Agjencisë, ose me një anëtar të Këshillit Drejtues të bankës, ose me një administrator të bankës së siguruar ose me personin i cili zotëron më shumë se pesë për qind të aksioneve me të drejtë vote në bankën e siguruar;

dh) ka munguar tre ose më shumë herë, në vazhdimësi, në mbledhjet e radhës të Këshillit Drejtues, pa shkak të arsyeshëm;

e) është në pamundësi, fizike ose mendore, për të mbuluar funksionet e ngarkuara mbi një vit;

ë) shkel rëndë etikën dhe cenon interesat e Agjencisë;

f) jep dorëheqjen ose vdes.

2. Asnjë anëtar i Këshillit Drejtues nuk pezullohet ose shkarkohet për shkaqe të tjera.

3. Anëtarët e këshillit njoftojnë dorëheqjen me shkrim në Agjenci jo më pak se tre muaj përpara largimit.

4. Çdo vend bosh në Këshillin Drejtues zëvendësohet me emërimin e një anëtari të ri, në zbatim të nenit 12 të këtij ligji, për të shërbyer deri në përfundimin e mandatit të anëtarit të zëvendësuar.

Neni 14
Mbledhjet e Këshillit Drejtues

1. Mbledhjet e Këshillit Drejtues kryesohen nga Kryetari. Anëtarët e Këshillit Drejtues zgjedhin Kryetar një nga anëtarët e këtij Këshilli. Kryetari i Këshillit Drejtues nuk është Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë.

2. Këshilli Drejtues mblidhet sa herë që kërkohet për realizimin e veprimtarisë së Agjencisë, por jo më pak se një herë në dy muaj kalendarikë. Këshilli Drejtues mblidhet me kërkesë të Kryetarit, të Drejtorit të Përgjithshëm ose të Autoritetit Mbikëqyrës, si dhe me kërkesën e jo më pak se dy anëtarëve të Këshillit Drejtues.

3. Çdo anëtar i Këshillit Drejtues ka të drejtën e një vote. Mbledhja e këtij Këshilli zhvillohet me praninë e më shumë se gjysmës së anëtarëve.

4. Vendimet e Këshillit Drejtues merren me votim të hapur, përveç rasteve kur bëhet votim për persona dhe kur Këshilli vendos ndryshe.

5. Mbledhjet e Këshillit Drejtues protokollohen. Protokolli nënshkruhet nga Kryetari dhe sekretari i Këshillit Drejtues. Sekretari nuk është anëtar i Këshillit Drejtues.

6. Kryetari i Këshillit Drejtues mbledh dhe kryeson këshillin. Në rast barazie të votave, vota e tij është përcaktuese.

7. Në mbledhjet e Këshillit Drejtues mund të ftohen edhe përfaqësues të bankave të siguruar, sa herë që gjykohet e nevojshme nga Këshilli Drejtues.

Neni 15
Deklarimi i interesave

1. Që në momentin e pjesëmarrjes në Këshillin Drejtues ose të emërimit si nëpunës në Agjenci dhe për çdo vit e më pas, anëtarët e Këshillit Drejtues dhe nëpunësit e Agjencisë deklarojnë pranë këtij Këshilli të gjithë interesat tregtarë, që kanë ata ose anëtarët e tjerë të familjeve të tyre. Këto deklarata bëhen sipas rregullave të miratuara nga Këshilli Drejtues.

2. Kurdoherë që shtrohen për diskutim në Këshillin Drejtues çështje në lidhje me këta interesa, anëtari që ka lidhje me çështjen deklaron interesat në fillimin e diskutimit dhe nuk merr pjesë në diskutimin dhe vendimin për këtë çështje. Prania e këtij anëtari llogaritet për efekt të pjesëmarrjes në mbledhje.

Neni 16
Drejtori i Përgjithshëm

1. Drejtori i Përgjithshëm emërohet dhe shkarkohet nga Autoriteti Mbikëqyrës, si rregull, me propozimin e Këshillit Drejtues. Këshilli Drejtues miraton afatet dhe kushtet e punësimit të tij.

2. Drejtori i Përgjithshëm vepron si drejtor ekzekutiv i Agjencisë. Të drejtat dhe detyrat e Drejtorit të Përgjithshëm rregullohen në statutin e Agjencisë.

3. Drejtori i Përgjithshëm përgjigjet përpara Këshillit Drejtues për zbatimin e vendimeve dhe të detyrave të Agjencisë.

Neni 16/1
Mbrojtja ligjore gjatë ushtrimit të detyrës
(Shtuar me ligjin nr. 10 106, datë 30.3.2009)

1. Agjencia, punonjësit e saj dhe anëtarët e këshillit drejtues nuk janë përgjegjës për

dëmet e shkaktuara të tretëve, nga veprimet ose mosveprimet e kryera gjatë ushtrimit të detyrës funksionale dhe përmbushjes së përgjegjësisë të tyre ligjore, të përcaktuara në këtë ligj.

2. Punonjësit e Agjencisë dhe anëtarët e këshillit drejtues, përjashtimisht, mund të përgjigjen për dëmet që u shkaktojnë personave fizikë ose juridikë, privatë, vetëm kur provohet se ata kanë vepruar me keqbesim.

3. Në rastet e parashikuara në pikën 2 të këtij neni, Agjencia, pasi dëmshpërblen palën e dëmtuar, ka të drejtë të kërkojë nga punonjësi fajtor kthimin e shpërblimit që ka paguar.

4. Në rastet kur punonjësi i paditur, në bazë të pikës 2 të këtij neni, deklarohet se nuk ka përgjegjësi, me vendim të formës së prerë të gjykatës përkatëse, Agjencia është e detyruar t'i rimbursojë atij shumën e plotë të shpenzimeve, që ai ka kryer për të realizuar përfaqësimin dhe mbrojtjen e tij ligjore.

5. Dispozitat e ligjit nr.8510, datë 15.7.1999 "Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore" nuk zbatohen për të përcaktuar përgjegjësinë jashtëkontraktore të Agjencisë, si dhe të organeve apo punonjësve të saj.

Neni 17

Konflikti i interesave

Drejtori i Përgjithshëm dhe punonjësit e Agjencisë nuk mund të hyjnë në marrëdhënie punësimi me bankat e siguruara, pavarësisht me shpërblim ose jo, përkohësisht ose pa afat.

Neni 18

Të dhënat

Asnjë person, që shërben ose ka shërbyer si anëtar i Këshillit Drejtues, drejtues a personel i Agjencisë, kontrollor i jashtëm, këshilltar, agjent a korrespondent i saj, nuk duhet që në mënyrë të paautorizuar me ligj:

a) të lejojë zbulimin ose publikimin e të dhënave jopublike, të cilat janë përfituar nga kryerja e detyrave në Agjenci;

b) të përdorë ose të lejojë që këto të dhëna të përdoren për përfitime personale.

Neni 19

Fondi themeltar

1. Fondi themeltar i Agjencisë është 400 000 000 (katërqind milionë) lekë.

2. Fondi themeltar është kontributi i Buxhetit të Shtetit.

3. Fondi themeltar nuk transferohet dhe nuk barrësohet.

4. Fondi themeltar, kontribut i Buxhetit të Shtetit, mund të rimbursohet në Buxhetin e Shtetit, sipas afateve dhe mënyrës së përcaktuar nga Këshilli Drejtues.

5. Fondi themeltar, gjatë kohës që është kontribut i Buxhetit të Shtetit, rritet me propozimin e Këshillit Drejtues dhe me miratimin e Këshillit të Ministrave.

Neni 20

Mjetet e tjera financiare

(Shtuar shkronja "d" me ligjin nr. 10 106, datë 30.3.2009)

Përveç fondit themeltar, në mjetet financiare të Agjencisë përfshihen:

a) kontributi fillestar i bankave të siguruara;

b) primet vjetore të bankave të siguruara;

c) kreditë, huatë, subvencionet dhe donacionet;

ç) të ardhura dhe fitime kapitali të përftuara nga aktivet e saj;

d) rimarrje nga likuidimet.

Neni 20/1

Mjetet financiare shitesë në rast të pamjaftueshmërisë së fondeve

(Shtuar me ligjin nr. 10 106, datë 30.3.2009; ndryshuar pika 3, shtuar pika 4, pika 4 bëhet pika 5 me ligjin nr. 78/2012, datë 26.7.2012)

1. Kur shuma që kërkohet për kompensimin e depozitave të siguruara është më e madhe se mjetet financiare të zotëruara, në kuptim të nenit 20 të këtij ligji, atëherë, me propozimin e këshillit drejtues dhe me miratimin e Autoritetit Mbikëqyrës, pamjaftueshmëria e fondeve mbulohet nëpërmjet njërës prej këtyre mënyrave:

a) bankat e siguruara, në përputhje me pikën 8 të nenit 24 të këtij ligji, detyrohen të paguajnë primin vjetor para afatit ligjor, duke marrë për bazë të llogaritjes së primit mesataren aritmetike të shumës së depozitave të siguruara, që janë regjistruar në bankë në ditën e fundit të muajit pararendës;

b) rritjes së primit vjetor të pagueshëm nga bankat e siguruara deri në nivelin e përcaktuar në pikën 3 të nenit 24 të këtij ligji.

2. Shuma e primit të paguar para afatit ligjor nga bankat e siguruara, në përputhje me shkronjën “a” të pikës 1 të këtij neni, zbritet nga shuma e primit vjetor, që banka e siguar duhet të paguajë në vitin pasardhës. Nëse shuma e primit të paguar para afatit ligjor është më e madhe se shuma e primit vjetor, që banka e siguar duhet të paguajë në vitin pasardhës, atëherë diferenca i rimbursohet bankës së siguar.

3. Huat apo kreditë e marra nga Agjencia, sipas nenit 20 të këtij ligji, për mbulimin e pamjaftueshmërisë së mjeteve financiare, përfshirë dhe ato që merren nga Buxheti i Shtetit, mund të garantohen me një garanci të lëshuar nga vetë Agjencia, duke përdorur asetet e saj apo pretendimet e ardhshme të Agjencisë për pagimin e primit vjetor nga bankat e siguruara.

4. Me propozimin e Këshillit Drejtues të Agjencisë dhe miratimin e Autoritetit Mbikëqyrës, subjektet e siguruara paguajnë një kontribut të veçantë, sipas nenit 20 shkronja “c” të këtij ligji, i cili përmbush kriteret e mëposhtme:

a) Kontributi i veçantë është kontribut i subjekteve të siguruara, që përdoret për qëllim të rindërtimit të mjeteve financiare, në rast të kompensimit të depozitave të siguruara, ose për shlyerjen e huave të Agjencisë të marra për këtë qëllim, në kuptim të nenit 20 shkronja “d” dhe të pikave 4 dhe 5 të këtij neni.

b) Kontributi i veçantë i subjekteve të siguruara mblidhet nga Agjencia vetëm një herë gjatë vitit kalendarik. Masa e kontributit të veçantë përcaktohet e njëjtë për të gjitha subjektet e siguruara dhe në çdo rast jo më shumë se 1 për qind e totalit të depozitave të siguruara që janë regjistruar në subjektin e siguar në ditën e fundit të muajit pararendës nga data e njoftimit të Agjencisë.

c) Kontributi paguhet nga subjektet e siguruara në lekë me marrjen e njoftimit nga Agjencia për vendimin e Autoritetit Mbikëqyrës mbi detyrimin e pagesës së tij dhe, në çdo rast, jo më vonë se data e përcaktuar në njoftimin e Agjencisë.

ç) Me propozimin e Këshillit Drejtues të Agjencisë, Autoriteti Mbikëqyrës përcakton subjektet e siguruara, të cilat, për arsye të ruajtjes së aftësisë paguese të tyre, mund të përjashtohen nga pagesa e kontributit të veçantë përkatë

5. Nëse mjetet financiare të siguruara sipas nenit 20 të këtij ligji dhe pikës 1 të këtij neni nuk janë të mjaftueshme, atëherë përdoren mjete financiare nga Buxheti i Shtetit.

Neni 21

Qëllimi i përdorimit të mjeteve financiare

(Shtuar fjalë në shkronjën “ç” të pikës 1, shtuar pika 4 me ligjin nr. 10 106, datë 30.3.2009;

ndryshuar me ligjin nr. 78/2012, datë 26.7.2012)

Mjetet financiare të Agjencisë, në kuptim të nenit 20 të këtij ligji, përdoren për:

- a) kompensimin e depozitave të siguruara, sipas dispozitave të këtij ligji;
- b) plotësimin e diferencës ndërmjet detyrimeve dhe aktiveve që transferohen nga një subjekt i siguar te një subjekt tjetër i siguar ose bankë-urë, sipas vendimit të Autoritetit Mbikëqyrës për këtë transferim, sipas pikës 6 të nenit 7 të këtij ligji;
- c) mbulimin e të gjitha shpenzimeve administrative për zbatimin e procesit të kompensimit të depozitave të siguruara dhe administrimin e aseteve të Agjencisë;
- ç) mbulimin e të gjitha shpenzimeve administrative dhe financiare për veprimtarinë e Agjencisë, sipas buxhetit të miratuar nga Autoriteti Mbikëqyrës;
- d) shlyerjen e detyrimeve, kredive dhe huave të marra për përmbushjen e qëllimeve të përcaktuara në shkronjat “a”, “b” dhe “c” të këtij neni.

Neni 21/1

Administrimi i mjeteve financiare

(Shtuar me ligjin nr. 78/2012, datë 26.7.2012)

1. Mjetet likuide të Agjencisë investohen vetëm në:
 - a) tituj të emetuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë ose Autoriteti Mbikëqyrës, në lekë dhe në monedhë të huaj;
 - b) tituj të emetuar nga qeveritë ose bankat qendrore në monedhë të huaj, të cilat konsiderohen të sigurt nga agjenci për vlerësimin e riskut të njohura ndërkombëtarisht;
 - c) tituj të emetuar nga institucionet financiare ndërkombëtare;
 - ç) depozita me interes në Autoritetin Mbikëqyrës.
2. Titujt e blerë nga Agjencia nuk duhet të jenë me maturitet më shumë se një vit që nga momenti i fitimit të pronësisë nga Agjencia.
3. Agjencia administron mjetet e saj financiare me qëllim që:
 - a) të eliminojë shpenzimet e pajustificuara administrative dhe operacionale;
 - b) të administrojë mjete financiare në investime në instrumente financiare me nivel të pranuar rreziku dhe shlyerjeje;
 - c) të garantojë plotësimin, në çdo kohë, të nevojave për mjete financiare likuide të Agjencisë;
 - ç) të zvogëlojë koston e oportunitetit dhe minimizimin e rrezikut të zhvleftësimit të mjeteve financiare të Agjencisë nga luhatja në këmbimet valutore;
 - d) të shlyejë në kohë detyrimet.
4. Me synim administrimin e mjeteve të saj financiare, sipas qëllimeve të parashikuara në pikën 3 të këtij neni, Agjencia mund të shesë me detyrim riblerjen e tyre, instrumente të detyrimeve të emetuara nga Ministria e Financave, sipas kushteve të miratuara nga Këshilli Drejtues i Agjencisë dhe Autoriteti Mbikëqyrës.
5. Ministria e Financave, Autoriteti Mbikëqyrës dhe Agjencia hyjnë në marrëveshje ndërmjet tyre për detyrime të parashikuara sipas pikës 4 të këtij neni, lidhur me sigurimin e mjeteve financiare të nevojshme për kryerjen e procesit të kompensimit nga Agjencia.
6. Agjencia e Sigurimit të Depozitave mban llogari pranë Autoritetit Mbikëqyrës.
7. Agjencia e Sigurimit të Depozitave mban në llogari të ndryshme, pranë Autoritetit Mbikëqyrës, mjetet financiare për depozitat e siguruara në bankat dhe degët e bankës së huaj dhe mjetet financiare për sigurimin e depozitave në shoqëritë e kursim-kreditit, në kuptim të nenit 20 të këtij ligji.

8. Pagesat e kontributit fillestar, pagesat e primit vjetor të sigurimit të depozitave, si dhe pagesat e kontributit të veçantë nga subjektet e siguruar derdhen në lekë në llogaritë përkatëse të Agjencisë pranë Autoritetit Mbikëqyrës.

Neni 22

Viti financiar

Viti financiar fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor.

Neni 23

Pranimi dhe përfundimi i sigurimit të depozitave

(Ndryshuar me ligjin nr. 10 106, datë 30.3.2009)

1. Subjektet, që kanë marrë miratimin paraprak për licencë nga Autoriteti Mbikëqyrës, brenda 12 muajve, bashkëpunojnë me Agjencinë për përgatitjen e kushteve teknike dhe organizative për plotësimin e kushtit për sigurimin e depozitave.

2. Subjektet, të cilat aplikojnë për marrjen e licencës, për të ushtruar veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë, pranë Autoritetit Mbikëqyrës, paraqesin njëkohësisht edhe kërkesën për pranimin në skemën e sigurimit të depozitave pranë Agjencisë së Sigurimit të Depozitave.

3. Kërkesa dhe dokumentacioni i nevojshëm për pranimin në skemën e sigurimit të depozitave rregullohet me akt nënligjor të Agjencisë.

4. Autoriteti Mbikëqyrës bashkëpunon me Agjencinë për shqyrtimin e kërkesës së subjektit që kërkon të licencohet, për të ushtruar veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë. Autoriteti Mbikëqyrës licencon subjektin, që kërkon të operojë si bankë, vetëm pasi ka administruar më parë opinionin e Agjencisë për kërkesën e kryer. Autoriteti Mbikëqyrës informon Agjencinë për dhënien e licencës bankare brenda tri ditëve nga marrja e vendimit.

5. Banka e siguruar, që ka marrë miratimin paraprak nga Autoriteti Mbikëqyrës për ndryshimin e emrit, transformimin e saj nëpërmjet bashkimit, shkrirjes apo çdo forme tjetër të riorganizimit juridik, paraqet menjëherë kërkesën pranë Agjencisë për pajisje me certifikatë të re të sigurimit të depozitave. Agjencia pasqyron ndryshimin në certifikatën e sigurimit të depozitave brenda dy ditëve nga data e regjistrimit të vendimit përkatës të transformimit në regjistrin tregtar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

6. Agjencia pranon kërkesën për sigurimin e depozitave të bankës së re jo më vonë se tri ditë nga data e marrjes së njoftimit me shkrim nga Autoriteti Mbikëqyrës për dhënien e licencës bankare. Me pranimin e kërkesës, Agjencia lëshon certifikatë për sigurimin e depozitave.

7. Çdo bankë e siguruar, kërkesa e së cilës pranohet nga Agjencia, sipas dispozitave të këtij ligji, paguan kontribut fillestar në Agjenci jo më vonë se 30 ditë kalendarike nga dhënia e licencës bankare nga Autoriteti Mbikëqyrës. Kontributi fillestar është 0,5 për qind e kapitalit të nënshkruar të bankës. Kontributi fillestar paguhet njëherësh, në lekë, në llogarinë e Agjencisë, në Autoritetin Mbikëqyrës. Këshilli drejtues i Agjencisë mund të vendosë përjashtimin nga detyrimi për pagesën e kontributit fillestar për bankat e reja, të cilat krijohen duke marrë përsipër depozitat dhe detyrimet e një banke të siguruar ekzistuese.

8. Sigurimi i depozitës në bankën e siguruar përfundohet nga Agjencia, kur Autoriteti Mbikëqyrës njofton me shkrim:

a) ndërhyrjen në bankën e siguruar;

b) revokimin e licencës bankare të bankës së siguruar.

9. Agjencia, jo më vonë se 24 orë nga vendimi për përfundimin e sigurimit të depozitës së bankës, njofton, me shkrim, Autoritetin Mbikëqyrës dhe bankën e siguruar. Njoftimi i Agjencisë botohet në Fletoren Zyrtare dhe, të paktën, në një gazetë kombëtare me tirazhin më

të madh.

Neni 24

Primi vjetor

(Shtuar pika 2.1, shtuar fjalë në pikën 7 me ligjin nr. 10 106, datë 30.3.2009; zëvendësuar fjalë në pikën 7 me ligjin nr. 78/2012, datë 26.7.2012)

1. Çdo bankë e siguruar i paguan Agjencisë primin vjetor të sigurimit të depozitës.
2. Për çdo bankë, primi vjetor i sigurimit të depozitës është 0,5 për qind e mesatares aritmetike të shumës së depozitave të siguruara që janë regjistruar në bankë në fund të çdo dite pune të tremujorit të fundit të vitit të shkuar.
- 2.1. Për qëllim të përlllogaritjes së primit, depozitat në valutë konvertohen në lekë, sipas kursit zyrtar të këmbimit, të përcaktuar nga Autoriteti Mbikëqyrës në ditën e vlerësimit.
3. Agjencia mund të rrisë primin vjetor të pagueshëm nga bankat e siguruara deri në 0,7 për qind të mesatares aritmetike të shumës së depozitave të siguruara që janë regjistruar në bankë në fund të çdo dite pune të tremujorit të fundit të vitit të shkuar. Rritja e primit vjetor bëhet me akt nënligjor për të gjitha bankat e siguruara.
4. Agjencia mund të ulë primin vjetor të pagueshëm nga bankat e siguruara deri në 0,1 për qind të mesatares aritmetike të shumës së depozitave të siguruara që janë regjistruar në bankë në fund të çdo dite pune të tremujorit të fundit të vitit të shkuar, por vetëm nëse mjetet financiare të Agjencisë janë jo më pak se 5 për qind të mesatares së këtyre depozitave. Ulja e primit vjetor bëhet me akt nënligjor për të gjitha bankat e siguruara.
5. Primi vjetor paguhet me këste në çdo tre muaj kalendarikë, por jo më vonë se 15 ditë kalendarike pas përfundimit të çdo tremujori. Për çdo vit me pagimin e kështit të parë tremujor, çdo bankë e siguruar i paraqet Agjencisë deklaratën e llogaritjes së primit sipas kërkesave të Agjencisë.
6. Pagesa e primit bëhet në lekë në llogarinë e Agjencisë në Autoritetin Mbikëqyrës.
7. Primi i parë vjetor i subjektit të porsalicencuar llogaritet mbi bazën e depozitave të regjistruara përgjatë 12 muajve të parë të veprimtarisë së kësaj banke. Vlerësimi i depozitave bankare të regjistruara për bankën e porsalicencuar bëhet nga Autoriteti Mbikëqyrës dhe Agjencia e Sigurimit të Depozitave. Primi i parë vjetor i bankës së porsalicencuar vlerësohet proporcionalisht me periudhën e mbetur nga momenti i licencimit nga Autoriteti Mbikëqyrës.
8. Pavarësisht nga kërkesat e pikës 5, me kërkesën e Agjencisë, për raste të veçanta dhe me miratim të Autoritetit Mbikëqyrës, primi vjetor mund të paguhet përpara afatit.

Neni 25

Kontabilizimi i kontributeve dhe i primeve

(Shtuar fjalë në pikën 2 me ligjin nr. 10 106, datë 30.3.2009; ndryshuar me ligjin nr. 78/2012, datë 26.7.2012)

1. Kontributet fillestare, primet vjetore dhe kontributet e veçanta llogariten si shpenzime të subjekteve të siguruara.
2. Kontributet fillestare, primet vjetore dhe kontributet e veçanta nuk rimbursohen, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj.

Neni 26

Përfashtimi dhe dënimi

(Ndryshuar pikat 2 dhe 3 me ligjin nr. 10 106, datë 30.3.2009)

1. Agjencia përjashton bankën e siguruar nga sigurimi i depozitave, kur bankës së siguruar i revokohet licenca për ushtrimin e veprimtarisë bankare.

2. Autoriteti Mbikëqyrës merr ndaj bankës së siguruar masat ndëshkimore, të parashikuara në ligjin nr.9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, të propozuara nga Agjencia, në rastet kur:

- a) nuk paguan kontributin dhe primin vjetor, sipas afateve ligjore;
- b) me gjithë kërkesën e Agjencisë, përlogarit primin në kundërshtim me formulën e përcaktuar në ligj;
- c) deklaron dhe komunikon të dhëna të pavërteta e të gabuara;
- ç) u komunikon depozituesve dhe të tretëve të dhëna të pavërteta ose të pasakta, sipas nenit 30 të këtij ligji;
- d) publikon dhe informon për sigurimin e depozitave, në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji.

3. Në rastet e përmendura në pikën 2 të këtij neni, përveç masave ndëshkimore, Autoriteti Mbikëqyrës mund të zbatojë dhe një ose disa nga masat e mëposhtme, pavarësisht nga renditja e tyre:

- a) urdhëron bankën e siguruar për pushimin e menjëhershëm të veprimeve, të konsideruara si kundërvajtje dhe marrjen e masave korrigjuese;
- b) urdhëron bankën e siguruar që, përveç masës së përmendur në shkronjën “a” të kësaj pike, t’i paguajë Agjencisë fitimin e munguar për mospagimin në kohë të kontributit fillestar dhe të primit të parë, në afatet e parashikuara në këtë ligj. Masa e fitimit të munguar përlogaritet në bazë të shumës së primit të papaguar, numrit të ditëve të vonesës, me interes të barabartë me interesin bazë, të përcaktuar nga Autoriteti Mbikëqyrës për periudhën kur është vënë re vonesa.

4. Agjencia detyrohet të njoftojë, në mënyrë të plotë dhe të detajuar, Autoritetin Mbikëqyrës për përjashtimin e bankës së siguruar, brenda 24 orëve nga çasti i marrjes së vendimit të përjashtimit.

Neni 27

E drejta për informacion

1. Në zbatim të dispozitave të këtij ligji, për realizimin e veprimtarisë dhe të detyrave të saj, Agjencia kërkon të dhëna nga bankat e siguruara dhe Autoriteti Mbikëqyrës. Autoriteti Mbikëqyrës dhe bankat e siguruara bashkëpunojnë dhe japin të dhënat e kërkuara nga Agjencia.

2. Agjencia informon rregullisht Autoritetin Mbikëqyrës dhe bankat e siguruara mbi politikat e sigurimit të depozitave, gjendjen financiare dhe për buxhetin e saj.

Neni 28

Kontabiliteti dhe raporti financiar i Agjencisë

1. Agjencia mban llogari e regjistra financiarë, që në çdo kohë duhet të pasqyrojnë në mënyrë të saktë gjendjen financiare të Agjencisë, në përputhje me ligjin “Për kontabilitetin” dhe me standardet ndërkombëtare.

2. Agjencia përgatit raportin dhe llogaritë financiare në fund të çdo viti financiar.

3. Raporti vjetor dhe dokumentet financiare të kontrolluara të Agjencisë i paraqiten Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, Këshillit të Ministrave dhe Autoritetit Mbikëqyrës jo më vonë se tre muaj pas përfundimit të çdo viti financiar.

Neni 29

Kontrolli

1. Llogaritë dhe regjistrat e Agjencisë mund të kontrollohen nga kontrollorë të jashtëm të specializuar, që caktohen nga Këshilli Drejtues.
2. Agjencia kontrollohet nga Kontrolli i Lartë i Shtetit.

Neni 30

Informimi i publikut

(Shtuar pika 4 me ligjin nr. 78/2012, datë 26.7.2012)

1. Bankat e siguruara nuk reklamojnë depozitat e siguruara mbi shumat e siguruara, të përcaktuara në këtë ligj.
2. Çdo bankë e siguruar dhe degë e bankës detyrohen të informojnë depozituesit për:
 - a) sigurimin e depozitës;
 - b) masën e kompensimit nga Agjencia;
 - c) kushtet dhe afatet e pagimit të kompensimit;
 - ç) procedurat e sigurimit dhe të kompensimit të depozitës;
 - d) rolin dhe qëllimin e veprimtarisë së Agjencisë.
3. Informacioni sipas pikës 2 publikohet periodikisht në kushtet e punës për depozitat dhe shpallet në mjediset publike të bankës, si dhe përfshihet në kushtet e punës në marrëdhënie me klientët.
4. Në rastin e transferimit të disa ose të të gjitha aktiveve dhe detyrimeve të bankës te një bankë tjetër ose një bankë-urë, përfshirë në çdo rast totalin e depozitave të siguruara, në rast se ky transferim bëhet në bazë të urdhrat të Autoritetit Mbikëqyrës para, gjatë kujdestarisë ose likuidimit, nuk është e nevojshme të merret miratimi i aksionarëve, depozituesve, kreditorëve ose palëve të treta.

Neni 31

Dispozitë tranzitore

(Ndryshuar me ligjin nr. 10 106, datë 30.3.2009; shtuar paragrafët me ligjin nr. 78/2012, datë 26.7.2012)

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, llogaritja e primit vjetor të sigurimit të depozitave për vitin 2009, për çdo bankë të siguruar, anëtare ekzistuese në skemën e sigurimit të depozitave, do të bëhet sipas dispozitave ekzistuese ligjore.

Shoqëritë e kursim-kreditit, brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, marrin të gjitha masat e nevojshme për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga ky ligj dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

Të gjitha depozitat e anëtarëve individë në shoqëritë e kursim-kreditit do të sigurohen sipas dispozitave të këtij ligji, pas kryerjes të pagesës së kontributit fillestar, sipas njoftimit të Agjencisë.

Neni 32

Aktet

(Ndryshuar pika 2 me ligjin nr. 10 106, datë 30.3.2009; shtuar pikat 4 dhe 5 me ligjin nr. 78/2012, datë 26.7.2012)

1. Ngarkohet Autoriteti Mbikëqyrës të nxjerrë aktet e propozuara nga Agjencia, në mbështetje dhe për zbatim të këtij ligji.
2. Aktet nënligjore të Agjencisë, me efekt për subjektet pjesëmarrëse në skemën e sigurimit të depozitave, botohen në Fletoren Zyrtare.
3. Autoriteti Mbikëqyrës lëshon rekomandime për bankën e siguruar me propozim të

Agjencisë për qëllimin e këtij ligji.

4. Ngarkohet Agjencia e Sigurimit të Depozitave që, brenda 3 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, t'i propozojë për miratim Autoritetit Mbikëqyrës kuadrin rregullator, në lidhje me përfshirjen e shoqërive të kursim-kreditit në skemën e sigurimit të depozitave, pranimin dhe përfundimin e sigurimit të depozitave, përjashtimin dhe dënimin, sipas dispozitave të parashikuara në këtë ligj.

5. Jo më vonë se 60 ditë kalendarike nga miratimi i kuadrit rregullator, sipas pikës 4 të këtij neni, Agjencia njofton shoqëritë e kursim-kreditit për politikën e sigurimit të depozitave dhe i udhëzon për shumën e kontributit dhe të primit vjetor fillestar që ato do të paguajnë për Agjencinë. Shuma e primit fillestar vjetor është proporcionale me periudhën e mbetur, sipas njoftimit të Agjencisë.

Neni 33

Ky ligj hyn në fuqi 6 muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr. 3288, datë 11.4.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Rexhep Meidani**